



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:224920

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05622619

C.nr.538/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve ... me seli në Prishtinë, rruga ..., të cilën e përfaqëson me autorizim A.A, kundër të paditurit B.K nga Mitrovica, rruga ..., me objekt kontesti rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit 10,801.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor e publik me datë 03.04.2024, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe të paditurit, me datë 25.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve ... me seli në Prishtinë, rr. ...

II. DETYROHET i padituri B.K nga Mitrovica, rruga ..., që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit të datës 08.10.2011, paditëses Kompania e Sigurimeve ... t'ia paguaj shumën prej 10,801.00 euro € (dhjetëmijë e tetëqind e një euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e pagesës së dëmit (17.08.2023) e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej 100 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve ... me seli në Prishtinë, rruga ... përmes të autorizuarit të tij, me datë 08.11.2017 ka parashtruar padi kundër të paditurit B.K nga Mitrovica, rr. ..., për rimbursimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti komunikacionit të datës 08.10.2011, në shumën prej 590.00€ (pesëqind e nëntëdhjetë euro) në emër të dëmit material, përfshirë kamatën dhe shpenzimet e procedurës. Ka shtuar se për dëmin e shkaktuar nga i padituri, të dëmtuarit Sh.S i është kompensuar dëmi i shkaktuar në veturë, ku paditësja ia ka paguar shumën prej 590.00 € dhe në bazë të Ligjit nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e dëmit nga shkaktari i aksidentit-këtu i padituri.

Në seancën gjyqësore të mbajtur më datë 03.04.2024, i autorizuari i paditëses ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin objektiv, duke kërkuar rimbursimin e dëmit jo material për të dëmtuarit F.K1, F.K2, L.K dhe Sh.B, të cilët kanë pësuar lëndime në aksidentin e datës 08.10.2011, në të cilën shkaktar ka qenë me 50% të përgjegjësishë, tani i padituri B.K, ku në momentin e aksidentit ka qenë pa patent shofer, me çka edhe ka humbur mbulesën siguruese. Ka theksuar se e dëmtuara Sh.B është kompensuar në shumën prej 2683 euro, i dëmtuari L.K është kompensuar në shumën prej 1341 euro, i dëmtuari F.K2 është kompensuar në shumën prej 1878 euro, si dhe e dëmtuara F.K1 së bashku me shpenzimet gjyqësore në shumën prej 4309 euro. Andaj, i autorizuari i paditëses ka theksuar se vlera e përgjithshme e padisë tani do të jetë 10,801 euro, duke përfshirë edhe shumën prej 590,00 euro të kërkuar si në padi për dëmin material në veturën e të dëmtuarit Sh.S, të gjitha me kamatë ligjore nga dita e pagesës së dëmit (17.08.2023), e deri në pagesën definitive, po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej 100 euro. Palës së paditur i ka ofruar mundësi që kontestin ta zgjidhin me marrëveshje dhe shumën ta paguaj me këste.

I padituri B.K nuk e ka kundërshtuar padinë e paditëses dhe e ka pranuar se ka qenë pjesërisht me 50% shkaktar i aksidentit të datës 08.10.2011, po ashtu nuk e ka kundërshtuar precizimin e bërë nga përfaqësuesi i paditësit pasi që shumat e cekura u janë paguar familjarëve të tij, por e ka kundërshtuar kërkesën e paditëses për kompensimin e kësaj shume sepse nuk ka mundësi financiare për ta paguar, ka theksuar se jeton me qira dhe është rast social, gjykatës ia ka prezantuar edhe kartelën e ndihmës sociale, aktualisht punon si taksist dhe realizon të ardhura diku 10 euro në ditë. Ofertën nga përfaqësuesi i paditëses për marrëveshje gjyqësore nuk e ka pranuar për shkak të pamundësisë financiare për ta paguar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykatë me datë 03.04.2024, bëri

administrimin e provave dhe atë: *raporti i aksidentit i datës 08.10.2011 me nr.2011-BO-1087, marrëveshja jashtëgjyqësore e datës 08.10.2014, e lidhur në mes Sh.S dhe paditëses Kompania e Sigurimeve ..., transferi bankar i datës 22.01.2015, kërkesa për rimbursimin e borxhit e datës 05.09.2023, urdhërtransferet bankare të datës 17.08.2023, për pagesën e dëmit të dëmtuarve, urdhërpagesat e dëmit të datës 09.08.2023, Aktgjykimi i GJTH Prishtinë C.nr.2687/11 i datës 20.02.2020, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit CA.nr.4490/20 i datës 27.02.2023, procesverbali i seancës së datës 11.02.2020 si dhe ekspertiza e komunikacionit e përpiluar nga eksperti Bajram Latifi me datë 23.04.2018.*

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga këto arsye:

Nuk ishte kontestuese se me datë 08.10.2011 në fshatin ... Komuna e Vushtrrisë ishte shkaktuar aksident i komunikacionit në të cilin ishte i përfshirë i padituri B.K i cili ishte pa mbulesë siguroese në momentin e shkaktimit të aksidentit, sepse nuk kishte patent shofer, në të cilin përveç dëmeve materiale të shkaktuara, lëndime kishin pësuar pasagjerët- familjarët e të paditurit B.K si dhe shoferi i automjetit tjetër Sh.S dhe bashkëshortja e tij si pasagjere.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësja dhe i dëmtuari Sh.S, me datë 08.10.2014 kishin lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit jo material, ndërsa me datë 17.08.2023, paditësja Kompania e Sigurimeve Sigal ua kishte kompensuar dëmin jo material të dëmtuarve në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.4490/2020 dhe atë të dëmtuarës Sh.B shumën prej 2683 euro, të dëmtuarit L.K shumën prej 1341 euro, të dëmtuarit F.K2 shumën prej 1878 euro, si dhe të dëmtuarës F.K1 së bashku me shpenzimet gjyqësore shumën prej 4309 euro. Këtë nuk e ka kundërshtuar as i padituri B.K, pasi që edhe në seancën e mbajtur pranë kësaj gjykate kishte deklaruar se familjarëve të tij u janë kompensuar këto shuma.

Nuk ishte kontestuese as baza juridike e kërkesëpadisë, pasi që i padituri e ka pohuar faktin vendimtar, përkatësisht se ishte shkaktar pjesërisht me 50% të përgjegjësisë i aksidentit të datës 08.10.2011, sepse siç është cekur edhe më lart, vet i padituri në seancën përgatitore dhe atë kryesore kishte deklaruar se nuk e konteston padinë e paditëses, por që nuk ka mundësi financiare që ta paguajë shumën e borxhit në emër të rimbursimit.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se i padituri mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar dhe se paditësja ka të drejtë të kërkoj rimbursimin-regresin e dëmit nga i padituri, përkatësisht themelësia e kërkesëpadisë së paditëses del nga dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/1-018, përkatësisht neni 14 par.1, pika 1.2 i cili përcakton se *“I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur: (1.2) drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimimit;”* e lidhur me paragrafin 3 të këtij neni i cili përcakton se: *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”*

Tutje, neni 136 par.1 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”*, ndërsa neni 960 par.1 i këtij ligji përcakton se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin. Andaj bazuar në këto dispozita ligjore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë si nga ana faktike ashtu edhe nga ana juridike dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.*

Gjykata, lidhur me kamatën ligjore u bazua në nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 dhe Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020 të datës 02.12.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u bazua në dispozitat e nenit 452 par.1 të LPK-së.

Mbi bazën e të lartcekurave, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.538/17, me datë 25.04.2024

Gj y q t a r i

Numri i lëndës: 2019:224920
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05622619

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.